



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:148478
Datë: 19.08.2024
Numri i dokumentit: 06061907

C.nr.5812/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Greta Ibraj, në çështjen juridike kontestimore të paditëses A. Sh., nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson H. B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prishtinë me objekt kontesti kompensim i diferencës së pa paguar në emër të kualifikimit, me vlerë të objektit të kontestit prej 3,819.15 €, jashtë seancës gjyqësore, më datë 19.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses A. Sh. nga Prishtina, ashtu që DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses, në emër të kompensimit të diferencës së pagave të pa paguara mbi bazën e kualifikimit në punë për periudhën kohore nga data 01.05.2017 deri më 31.01.2023, (69 muaj x 55.35 €) për kualifikimin Bachelor në vlerë të 27% të pagës bazë, t'ia kompensojë shumën në vlerë prej 3,819.15 € (tremijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë euro e pesëmbëdhjetë centë), me kamatë ligjore në lartësi prej 8 % në vit nga data e paraqitjes së padisë, datë 08.07.2021 e deri në pagesën e tërësishme, të gjitha këto brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 144.00 € (njëqind e katërdhjetë e katër euro), brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A. Sh. përmes të autorizuarit të saj, më datë 08.07.2021 pranë kësaj Gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i diferencës së pa paguar në emër të kualifikimit. Të njëjtën e ka precizuar sipas parashtrësave të datave 10.05.2023 dhe 06.02.2024.

Në padi dhe precizim ndër tjera theksohet se paditësja është e punësuar tek e paditura me kontratë pune në institucionin arsimor SH.F.M.U. "I. Q." në Prishtinë, me kualifikim shkollor Fakultet, ku sipas nenit 7 par.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 18.04.2017, i takon kompensimi prej 27% e pagës bazë. Ka shtuar se deri më tani, paditëses i është paguar shuma prej 58.32 € mbi pagën bazë prej 421.00 €, ashtu që ka mbetur pa iu paguar diferenca prej 55.35 € për çdo muaj. Më tutje ka shtuar se paditësja i është drejtuar të paditurës në procedurë jashtëgjyqësore me kërkesë për realizimin e kësaj të drejte, por nuk ka marrë përgjigje. Me parashtrësën e datës 06.02.2024 paditësja e ka bërë precizimin dhe zgjerimin e kërkesëpadsisë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të aprovojë kërkesëpadsinë dhe të detyrojë të paditurën për kompensimin e diferencës së papaguar, në shumën prej 55.35 € për çdo muaj, e në shumën e përgjithshme 3,819.15 € (tremijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë e pesëmbëdhjetë centë), për 69 muaj për periudhën 01.05.2017 deri me datë 31.01.2023, me kamatë ligjore prej 8% në vit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadsinë e paditëses, me arsyetim se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune me Drejtorinë Komunale të Arsimit në Institucionin Arsimor SH.F.M.U "I. Q." më datë 01.09.2011. Ka theksuar Kontrata e lidhur me paditëses dhe punëdhënësit, është e lidhur në bazë të të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës si dhe Ligjit Nr.03/L-068 për Arsim në Komunitat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068 dhe e njëjta është përmbajtur në tërësi nga punëdhënësi dhe paditësja e ka marrë kompensimin gjatë punës së saj. Më tutje, ka theksuar se e paditura gjatë planifikimit të buxhetit nuk ka planifikuar linjë të veçantë buxhetore për këto lloje kompensimi, nga këto arsye i ka propozuar Gjykatës që kërkesëpadsinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të papabuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

Me rastin e pranimi të përgjigjes në padi, gjegjësisht vlerësimit të pretendimeve të palëve e në lidhshmëri me vlerësimin e provave të bashkangjitura, kjo Gjykatë erdhi në përfundim se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor mbi aprovimin e kërkesëpadsisë së paditëses pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës nga neni 398 të LPK-së, e cila përcakton: "*Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadsinë.*"

Nga provat e bashkangjitura padsisë, Gjykata gjeti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, e sistemuar në vendin e punës si mësimdhënëse e gjuhës angleze, në Institucionin Arsimor SH.F.M.U. "I. Q." në Prishtinë. Ky fakt vërtetohet sipas Kontratës së Punës me numër protokollit 135, të datës 01.09.2011. Një fakt i tillë, po ashtu është vërtetuar edhe nga Vendimi Nr.140/2021, i datës 18.06.2021. Në bazë të listës së pagave nga Buxheti i Republikës së Kosovës, me numër të punëtorit: EM00154872, vërtetohet se paditësja e ka pagën bazë mujore në shumën prej 421.00 € dhe se paditëses në emër të kualifikimit i është paguar shuma prej 58.32€. Nga Diploma Nr.193, e datës 12.05.2009, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i

Edukimit në Prishtinë, rezulton se paditësja ka marrë titullin Baçelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Ndërsa, në bazë të Licencës së mësimdhënësit Nr.100015663 e lëshuar me datë 13.06.2013 nga MASHT, rezulton se paditësja është e licencuar me Licencë të Rregullt Karriere.

Sipas nenit 329 par. 1 të LPK-së: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”* Së këndejmi, provave që kishin të bënin me vërtetimin e fakteve lidhur me marrëdhënien e punës, lartësinë e pagës dhe kompensimin për kualifikim, Gjykata ia fali besimin e plotë, sepse është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Në raport me bazën juridike të mbështetjes së kërkesëpadisë, Gjykata fillimisht iu referua Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të lidhur me datë 18.04.2017, me rastin e nënshkrimit nga Organizatat e të Punësuarve (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës), si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë), e cila Kontratë ka gjetur zbatim për periudhën kohore 18.04.2017 - 21.01.2021. Dispozita nga neni 7, pika 1.3 dhe 1.4 e Kontratës së lartcekur, përcakton që: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënësit me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë; 1.4. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçare, magistraturë/master dhe doktoraturë 35% të pagës bazë.”*

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të mbështetjes së kërkesëpadisë, Gjykata po ashtu iu referua edhe Vendimit Nr.01/33, të datës 29.08.2008, të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ku në pikën 3 të këtij Vendimi shprehimisht përcaktohet që: *“Ngritja e pagave për mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në nivelin fillor dhe atë të mesëm bëhet në bazë të kriterëve të licencimit, si: përgatitja profesionale (kualifikimi) dhe përvoja e punës”.* Pika 4 e të njëjtit vendim përcakton që: *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur: Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagesës bazë prej 27%; Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoratë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%.”*

Së fundmi, Gjykata iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, GJ.A-Su.A, 214/2023, të datës 09.10.2023, specifikisht pikës I të këtij Mendimi, ku përcaktohet: *“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33, të datës 29.08.2008.”* Në arsyetim të këtij Mendimi Juridik është sqaruar se Vendimi i lartcekur ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023, (kur edhe është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik Nr.08/L-196), ndërsa tutje është sqaruar edhe fakti se mbështetja e kërkesëpadisë për kompensim mbi bazën e kualifikimit në këtë Vendim nga ana e mësimdhënësve është në shërbim të sigurisë juridike.

Në këtë mënyrë, vlerësimi përfundimtar i Gjykatës konsiston në faktin se paditësja është pajisur me licencë të mësimdhënësies së karrierës me datë 13.06.2013, ndërsa ka fituar titullin Baçelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze më datë 12.05.2009. Në rastin konkret, kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e pagës mbi bazën e kualifikimit përfshin periudhën kohore 01.05.2017 – 31.01.2023, periudhë kjo gjatë së cilës Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr.01/33, i datës 29.08.2008 ka qenë në fuqi, gjegjësisht ka prodhuar efekte juridike. Mbi këtë bazë, e njëjta mund t'i gëzojë benefitet e përcaktuara me Vendimin e lartcekur, respektivisht të drejtën e përfitimit të ngritjes së pagës bazë në vlerën prej 27% mbi bazën e kualifikimit, të përcaktuar në pikën 4 të Vendimit të lartcekur.

Në prezencën e rrethanave të lartcekura, Gjykata vlerëson se paditësja është legjitimuar të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura përmes rrugëve gjyqësore, respektivisht është krijuar marrëdhënia e detyrimit mes palëve ndërgjyqëse, në kuptim të dispozitës nga neni 245 të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, ku parashihet *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Mbi këtë bazë, është bërë përlllogaritja në atë mënyrë që fillimisht është përlllogaritur vlera prej 27% e pagës bazë së paditëses (421.00 x 27%), nga e cila përlllogaritje ka dalë shuma prej 113.67 €. Nga shuma e lartcekur është zbritur shuma në vlerë prej 58.32 €, e cila i është kompensuar paditëses në kuadër të pagës mujore, ndërsa ka ngelur shuma prej 55.35 €. Meqenëse kërkesëpadia e paditëses përfshin periudhën kohore prej 69 muaj, vlera e lartcekur (55.35 €) është shumëzuar me numrin 69, nga e cila përlllogaritje Gjykatës i rezulton se paditëses i takon e drejta në kompensim në shumën e përgjithshme prej 3,819.15 € (55.35 x 69 = 3,819.15). Bazuar në këto konstatime, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë në konsideratë edhe dispozitën nga neni 2 par.1 të LPK-së, e cila përcakton: *“Në procedurë kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse.”*

Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës përmes përgjigjes në padi, që përqendrohen në rrethanat: se paditësja e ka marrë kompensimin e duhur gjate punës së saj dhe po ashtu pretendimi se gjatë përgatitjes së buxhetit, nuk është paraparë linjë e veçantë buxhetore për këto lloje të kompensimit.

Sa i përket pretendimit të paditurës se paditësja e ka marrë kompensimin e duhur gjatë punës së saj, gjykata e vlerësoi si të pa bazuar. Kjo, për faktin se gjatë punës së saj, paditësja ka marrë vetëm një pjesë të kompensimit që do t'i takonte në emër të kualifikimit. Ndërkaq, arsyet më të thukëta lidhur me këtë vendosje, janë dhënë përgjatë arsytimit të këtij vendimi përkitazi me bazën e kërkesëpadiës dhe përlllogaritjen e lartësisë së kërkesëpadiës që i është njohur palës paditëse.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një

rrethanë e tillë nuk mund të konsiderohet pengesë që paditësja t'i realizojë të drejtat e garantuara me Kontratë Kolektive, dispozitat e së cilës janë të karakterit obligativ, mbi bazën e plotësimit të kushteve dhe ekzistimit të rrethanave të cilave Gjykata i është referuar më sipër në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Gjykata në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi vendosi edhe lidhur me kërkesën aksesore, duke e detyruar të paditurën që shumat e gjykuara nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi, t'ia paguajë paditëses së bashku me kamatën ligjore prej 8% në vit, e cila do të llogaritet nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Një vendosje e tillë është mbështetur në dispozitën nga neni 382 të LMD-së, e cila parashihet që: *"Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë"*.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditësja t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme në vlerë të përgjithshme prej 144.00 € dhe atë: 104.00 € në emër të përpilimit të padisë dhe 40.00 € në emër të taksës për padi. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrit tarifor 6).

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 160 lidhur me nenin 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.5812/2021, më datë 19.08.2024

Gjyqtarja

Greta Ibraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë Ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.